



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 57, Datë 10.03.2025

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHKURT 2025 PËR  
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.03.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1228/1 prot., datë 07.03.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin shkurt 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

**Konstatohet se:**

- FSHU sh.a me shkresën nr. 1069 prot., datë 28.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 1228 prot., datë 03.03.2025, ka depozituar në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin shkurt 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin shkurt 2025 shoqëria FSHU sh.a. e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).
- Për përllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), FSHU sh.a. është bazuar në blerjet ditore/mujore të saj në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për muajin shkurt 2025, profilet ditore të prokuruar në Bursë, çmimin ditor/orar si dhe vlerën e faturës ditore.
- Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) i përllogaritur nga shoqëria për muajin shkurt 2025 është 15.82 lekë/kwh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rillogaritja

e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 15.82 lekë/kwh.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2025 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
  - **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 shkurt 2025 – 31 Dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024, është 0.85 lekë/kWh.
  - **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV**, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.04.2022”, është 1.55 lekë/kWh.
  - **Kostot administrative**, prej 1.06 lekë/kWh.
  - **Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (Lekë/Euro)**, për çdo datë respektive të harkut kohor 31.01.2025 – 27.02.2025.
- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2025, përlllogaritet si më poshtë:

<b>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin shkurt 2025</b>			
		<b>Njësia</b>	<b>Çmimi</b>
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë	Lekë/kWh	15.82
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin	Lekë/kWh	0.47
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
<b>Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA</b>		<b>Lekë/kWh</b>	<b>19.76</b>

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
  - Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *19.76 Lekë/kWh për muajin shkurt 2025*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2025 prej 19.76 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**